



MBLEDHJE E BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Tiranë më 18.04.2017

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës **18.04.2017** shqyrtoi relacionet e përgatitura nga Drejtoritë Teknike të ERE si më poshtë:

- Mbi fillimin e procedurës për licencimin e Shoqërisë “Alb Energy Market” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.
- Mbi fillimin e procedurës për licencimin e Shoqërisë “Alb Energy Market” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ALB-ENERGY” sh.p.k., për lënien garanci (hipotekë) të aseteve të saj, në favor Bankës Societe Generale Albania sh.a.
- Mbi miratimin e draft-kontratë/marrëveshjes për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a dhe OSHEE sh.a për tepricat e energjise elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2017-31.12.2017.
- Mbi miratimin e Rregullores për procedurat e heqjes së licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.
- Mbi fillimin e procedurave për miratimin e “Rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike”.